

VENDIM
Nr.310, datë 24.7.1992

PËR KOMPENSIMIN PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA RRITJA E ÇMIMEVE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të të Përndjekurve Politikë, si dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. T'u jepet një kompensim mujor për frymë:

1. Në masën deri në 280 lekë në muaj:

a) të punësuarve në sektorin shtetëror e privat;

b) personave që marrin përkrahje sociale nga zbatimi i reformës ekonomike;

c) personave që marrin pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore", si dhe atyre që marrin pension familjar, kur janë të vetëm ose kur janë kryefamiljarë;

ç) personave që marrin ndihmë ekonomike, kur janë të vetëm ose kur janë kryefamiljarë;

d) studentëve që përditojnë bursë, kur janë kryefamiljarë.

2. Në masën deri në 200 lekë në muaj për frymë:

a) personave që janë efektivisht në ngarkim të atyre që përmenden në pikën 1 të këtij kapitulli.

b) Personi mbi një e lart që është në ngarkim të ushtarakut të shërbimit aktiv, kur paga së bashku me shtesat mbi pagë është deri 2400 lekë në muaj;

c) personi mbi një e lart që është në ngarkim të ushtarakut që del në lirim nga zbatimi i reformës ekonomike dhe që sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.255, datë 29.5.1992, merr deri 2400 lekë në muaj.

Quhen persona në ngarkim të gjithë ata që janë në regjistrin e familjes dhe që nuk përfitojnë kompensim pikës 1 të kapitullit I.

I. Nuk quhen persona në ngarkim, për efekt të llogaritjes së kompensimeve, ata që janë refugjatë jashtë shtetit ose në emigracion.

II. Nuk përfitojnë kompensim mujor për frymë:

1. Pensionistët që kanë përfituar pension sipas ligjit "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", si dhe pjesëtarët e familjes së tyre, që ata kanë në ngarkim sipas pikës 2 të kapitullit të parë të këtij vendimi.

2. Personat që përmenden në pikën 2 të kreut I, kur familja e tyre ka tokë në pronësi ose në përdorim.

3. Të vetëpunësuarit në sektorin privat që nga koha e marrjes së lejes së ushtrimit të profesionit.

4. Personat që janë në ngarkim të pensionistit, i cili është njëkohësisht i vetëpunësuar në sektorin privat, që nga koha e marrjes së lejes së ushtrimit të profesionit.

5. Ushtarakët e shërbimit aktiv dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm.

6. Nxënësit dhe studentët e shkollave ushtarake që marrin pension familjar (nuk përfitojnë kompensim për periudhën e vitit mësimor).

7. Nxënësit dhe studentët që studiojnë jashtë shtetit me bursë të shtetit, të organiztave ndërkombëtare e të shoqërive të ndryshme, për kohën që trajtohen me bursë.

8. Punonjësit që dërgohen jashtë shtetit për studime, specializime, specializime pasuniversitare, ose për të ndjekur kurse të ndryshme mbi 3 muaj. Anëtarët e familjes që ata kanë në ngarkim, trajtohen sipas pikës 2 të kreut I.

9. Personat që janë refugjatë jashtë shtetit ose emigrantë.

III. Për mënyrën e llogaritjes dhe të pagesës së kompensimit për frymë:

1. Për të përfituar këtë kompensim paraqitet deklarata sipas modelit bashkëlidhur. Personi që nuk përcakton të vërtetën në deklarata ose nuk njofton brenda 15 ditëve për çdo ndryshim të deklaratës, detyrohet të kthejë 20-fishin e kompensimeve të përfituara padrejtsisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund t'i bëhet. Urdhëri lëshohet nga drejtuesi i ndërmarrjes ose i institucionit, ku

janë marrë kompensimet, dhe është titull ekzekutiv.

2. Kompensimet llogariten nga deklaruesi, sa bashku me punonjësën e ngarkuar përkatësisht nga qendra e punës, zyrat e punës, drejtoritë e sigurimeve shoqërore, seksionet e financës dhe shkollat, duke e ndarë ngarkesën në raport të barabartë ndërmjet dy mbajtësve të familjes (që si rregull janë burri dhe gruaja).

3. Pagesa e kompensimit bëhet një herë në muaj nga qendra e punës, nga punëdhënësit shtetëror ose privat, nga zyrat e punës dhe qendrat ku paguhën pensionet, nga seksionet e financës dhe për bursistët atje ku merret bursa. Kompensimet regjistrohen në kollonë të veçantë në borderotë e pagesave (pagat, pensionet, bursat etj.) dhe jepen në fillim të muajit.

4. Në ndërmarrjet buxhetore dhe në institucionet buxhetore, si dhe për pensionet, përkahjen sociale e ndihmat ekonomike, fondet për kompensimet e mësipërme përballohen nga buxheti i shtetit, duke i dhënë personit kompensim të plotë për vetë prej 280 lekësh në muaj, si dhe kompensimin e plotë për personat që atij i takojnë të ketë në ngarkim sipas pikës 2 të kapitullit I.

Ndërmarrjet dhe institucionet jobuxhetore, fondet për kompensim i përballojnë vetë në ngarkim të shpenzimeve të aktivitetit, duke i dhënë personit kompensimet sipas mundësive ekonomike që ato kanë, brenda kufijve të miratuar në pikën 1 e 2 të kreut të I, përkatësisht deri më 280 lekë dhe deri në 200 lekë në muaj. Kompensimet do të jepen deri në miratimin e sudimit të sistemit të pagave, i cili do të marrë në konsideratë rritjen e tyre për efekt të inflacionit.

Punëdhënësit privatë përballojnë kompensimet për të punësuarit në sektorin e tyre.

5. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të bëjë detajimin e fondeve të miratuara që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për çdo ministri e institucionin tjetër qendror.

6. Për përballimin e vëllimit të punës që krijohet si efekt i zbatimit të këtij vendimi, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen për vitin 1992 një fond page prej 1,2 milion lekësh dhe Minsitrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të të Përndjekurve Politike i shtohen për vitin 1992 një fond page prej 1,1 milionë lekësh.

7. Aparati i Këshillit të Ministrave të organizojë shumëfishimin dhe shpërndarjen e deklaratës brenda muajit gusht të vitit 1992. Për përballimin e shpenzimeve shtohen 1 milionë lekë për shpenzimet buxhetore të vitit 1992.

8. Për zbatimin e menjëhershëm të këtij vendimi, në sektorët ku kompensimi përballohet nga buxheti i shtetit, pagesat e kompensimeve të muajit gusht të bëhen në fillim të muajit për personat që përfitojnë sipas pikës 1 të kapitullit të parë të këtij vendimi dhe për një person në ngarkim (në qoftë se ka sipas pikës 2 të kapitullit I) pa plotësuar deklaratën përkatëse. Në muajin shtator të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm, të bëhen llogaritjet e plota dhe pagesat të jepen nga data e hyrjes në fuqi të vendimit. Përgjatimisht për muajin gusht, në rast se dokumentacioni plotësohet i rregullt sipas kërkesave të këtij vendimi, bëhen llogaritjet për diferencat që mund të lindin. Rekomandimet që edhe në sektorët e tjerë të veprohet si më sipër.

9. Ngarkohet Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Minsitria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve të lëshojnë udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 gusht 1992.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ALEKSANDËR MEKSI

DEKLARATË
PËR PËRBËRJEN FAMILJARE PËR EFEKT TË KOMPENSIMEVE PËR FRYMË TË
SHPENZIMEVE NGA RRITJA E ÇMIMEVE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË

Deklaroj nën përgjegjësinë personale se familja ime në datën.....përbëhet nga këta persona:

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Lidhja me kryefamiljarin	Datëlindja (dita, muaji, viti)	Qendra e punës ku punojnë	Punësuar në sektor privat ose vetëpunësuar	Disponon tokë familja ose jo	Kompensime t në lekë	s shënime

a	b	1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---	---	---

Llogaritja e kompensimeve për secilën mbajtës

1. Numri i mbajtësve (si rregull burri dhe gruaja)
 2. Numri i personave të ngarkesës
 3. Shuma e kompensimeve të ngarkesës (200x numri rendor 2)
 4. Ngarkesa për çdo mbajtës (nr. 3: nr. 1)
 5. Kompensimi gjithsej që përfiton mbajtësi (280 + nr. 4)
- Deklaruesi përfiton kompensimin gjithësej në lekë.....

DEKLARUESI PERSONI I NGARKUAR PËR LLOGARITJET E
KOMPENSIMIT

Emri, mbiemri Emri, mbiemri

Shënim:

1. Çdo i punësuar në punëdhënëse shtetërore ose private, person që merr përkrahje sociale nga zbatimi i reformës ekonomike, pensionisti dhe person i vetëm që është pa të ardhura dhe që merr ndihmë ekonomike, paraqet deklaratën atje ku merr pagën ose përkrahjen sociale, ku i caktohet pensioni ose ndihma ekonomike.

2. Plotësohet nga vetë deklaruesi për të gjithë përbërjen e familjes, e cila të jetë e njëjtë me regjistrimin në gjendjen civile për kollonat b, 1, 2.

3. Në kollonën 3, për personat e tjerë në ngarkim të shënohet për të papunët, "i papunë" ose shkolla ku mëson, studion, repartit ku kryen detyrimin ushtarak, ku e merr përkrahjen sociale, pensionin etj.

4. Deklaruesi në kolonën 4 e 5 shënon "po" apo "jo".

5. Kolona 6 plotësohet nga deklaruesi, së bashku me personin e ngarkuar nga qendrat e punës, ose me personin e ngarkuar atje ku bëhen pagesat për përkrahjen sociale, ku caktohen pensionet dhe ndihmat ekonomike.

6. Për çdo ndryshim në përmbajtjen e deklaratës njoftohet brenda 15 ditëve.

7. Në të gjitha rastet për shumën e marra padrejtësisht deklaruesit, detyrohet të kthejë 20 fishin e kompensimeve të përfituara padrejtësisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund t'i bëhet. Urdhri i lëshuar nga drejtuesi i ndërmarrjes ose i institucionit është titull ekzekutiv.